

VENDIM
Nr.250, datë 15.4.2005

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT KONTABËL TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 shkronja “b” dhe 5 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e manualit kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PARATHENIE E MANUALIT KONTABEL TE AGJENCISE SE SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit te Depozitave eshte themeluar me Ligjin Nr.8873, date 29.03.2002, i cili percakton qarte statusin e saj dhe veprimtarine e saj.

Ashtu sikurse permendet ne nenet 3, 4 dhe 5 te Ligjit Nr.7661, date 19.01.1993 "Per kontabilitetin", Agjencia e Sigurimit te Depozitave ashtu sikur Banka e Shqiperise, bankat e nivelit te dyte, institucionet financiare si dhe subjektet e tjera qe ushtrojne veprimtari financiare, zbatojne sisteme kontabel te vecanta. Sistemi kontabel i Agjencise paraqitet si manual kontabel.

Manuali Kontabel i Agjencise se Sigurimit te Depozitave eshte pergatitur duke u bazuar dhe ne respekt te statutit juridik te Agjencise i cili percaktohet ne Ligjin Nr.8873, date 29.03.2003, ne karakteristikat e veprimtarise se Agjencise te cilat percakohen ne Ligj, ne Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (S.N.R.F), te Planit Kontabel te Bankave, te Manualit Kontabel te Bankes se Shqiperise, te Planit Kontabel te Pergjithshem, te Ligjit Nr.7661, date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin", te Ligjit Nr.9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", te pervojes se ngjashme te vendeve te zhvilluara dhe te vendeve te ngjashme me Shqiperine.

Agjencia e Sigurimit te Depozitave eshte nje institucion financiar unikal, ashtu sikurse simotrat e saj ne gjithe boten, prandaj edhe Manuali Kontabel i saj eshte unikal dhe respekton sa me siper.

Manuali Kontabel i Agjencise gezon te gjitha karakteristikat e manualeve kontabel, me te vetmin ndryshim si ai eshte i perdorshem nga nje numur i kufizuar specialistesh kryesisht ata qe punojne prane Agjencise se Sigurimit te Depozitave.

Manuali Kontabel i Agjencise se Sigurimit te Depozitave eshte organizuar ne 4 pjese dhe nje udhezues.

Pjesa e pare jep:

1. Parimet e pergjitheshme qe udheheqin aktivitetin (veprimtarine) e ASD.
2. Parimet kontabel
3. Parimet e pergjitheshme te mbajtejes se llogarive.
4. Planin e llogarive.
5. Listen e llogarive.

Pjesa e dyte jep: PERMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E LLOGARIVE

Kjo pjese ndahet ne 9 seksione dhe konkretisht:

1. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre
2. Investime ne Letra me Vlere (Bono Thesari dhe Obligacione deri ne nje vit)
3. Kerkesa per Arketim (ndaj Bankave te Falimentuara)
4. Aktive te tjera
5. Hua/Kredi
6. Kompensimi i Depozitave te Siguruara
7. Provigjonet
8. Fondet
9. Te ardhura dhe shpenzime.

Pjesa e trete jep: VEPRIMET BAZE TE ASD

Pjesa e katert jep:

1. Parimet baze per Pasqyrat Financiare
2. Pasqyrat Financiare dhe spjegimet e tyre
3. Bilanci
4. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve
5. Pasqyra e rrjedhes se parase (CASH-FLOW)
6. Pasqyra e shperndarjes se fitimit
7. Pasqyra e levizjes se fondeve

Udhezuesi jep: UDHEZIMET DHE KOMENTET PER PLOTESIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Manuali u hartua nga zoti Kosta Niko, Profesor i Asocuar, Doktor, Ekspert Kontabel i Autorizuar, dhe eshte prone e Agjencise se Sigurimit te Depozitave.

Manuali është hartuar duke respektuar të gjitha parimet dhe rregullat, por vecanerisht parimin e kujdesit.

Cdo ndryshim në bazën e mesiperme të hartimit të tij dhe në respekt të saj, do të reflektohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

AGJENCIA E SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

PJESA I

1. PARIME TE PERGJITHESHME QE UDHEHEQIN AKTIVITETIN E AGJENCISE SE SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

Veprimtaria e Agjencise udhehiqet nga tre parime baze te pergjitheshme

1. Parimi i likujditetit
2. Parimi i sigurise
3. Parimi i kujdesit

1. Parimi i likujditetit

Likujditeti eshte aftesia e nje ndermarrjeje per te perballuar detyrimet e saj rrjedhese, ndersa per Agjencine shtohet edhe per te perballuar ne cdo moment detyrimet e saj kundrejt depozitave te siguruara dmth bankave te nivelit te dyte per depozitat e siguruara sipas ligjit.

Agjencia e Sigurimit te Depozitave per vet natyren e saj te aktivitetit mund te siguroje nje likujditet maksimal ne cdo rast. Po a do te ishte i nevojshem likuiditeti ne nje nivel te tille?

Meqenese fruaajtja ne maksimum e likujditetit eshte e pakuptimte, Agjencia e investon ate ne investime financiare likuide me risk minimal.

Per perballimin e situatave teper te vecanta Agjencia mund te siguroje likujditet edhe nga buxheti i shtetit, kredite, huate apo donacionet.

2. Parimi i sigurise

Rreziqet qe mund te perballoje Agjencia ne rastet e falimentimit te Bankave jane shume te medha. Prandaj eshte e domosdoshme qe investimet financiare pavarsisht riskut minimal te diversifikohen ne nje portofol sa me te sigurt. Ajo duhet te garantoje me aktivitetin e saj arketimin ne kohe te primeve nga bankat dhe te jete e kujdeseshme ne investime dhe shpenzime te medha te menjehereshme. Pra duhet te siguroje nepermjet politikave te saj nje likujditet optimal momental te perdorshem ne kohen e duhur.

3. Parimi i kujdesit

Parimi i kujdesit lidhet ngushte me dy aspekte themelore:

- Me vendimarjen e cila duhet te garantoje zbatimin e dy parimeve te mepareshme
- Me studimin ne vijimesi te tregut bankar ne menyre direkte dhe nepermjet Autoritetit Mbikqyres ne menyre qe cdo moment te jete e pergatitur per te parashikuar dhe perballuar ndodhite.

Parimet e mesiperme pavaresisht se dalin te vecanta ato jane ne bashkeveprim reciprok dhe garantojne realizimin e qellimit te Agjencise se Sigurimit te Depozitave.

2. PARIMET KONTABEL

Parimet kontabel perkufizojne rregullat baze ne menyre qe te sigurohet perdorimi i parimeve themelore kontabel per hartimin e pasqyrave financiare dhe pasqyrimin e transaksioneve kontabel. Ne rast se ka me shume se nje mundesi per nje transaksion te vecante, parimi i zgjedhur duhet te zbatohet ne menyre te qendrueshme.

Parimet kontabel jane pergjithesisht te zbatueshem me ane te Standarteve Kontabel. Standartet kontabel jane rregulla qe synojne te minimizojne dallimet midis parimeve kontabel detyruese te mara si baze ne pershkrimin e transaksioneve kontabel po ashtu edhe ne ndertimin e pasqyrave financiare dhe anes praktike.

Parimet e vijueshmerise, perputhjes dhe te drejtave te konstatuara, qendrueshmerise, njesise kontabile, materialitetit, kujdesit, neutralitetit dhe besueshmerise, permbajtjes mbi formen, dhe moskompensimit jane pranuar si parime baze te kontabilitetit te Agjencise se Sigurimit te Depozitave (qe ketej e me tutje Agjencia). Parimet baze detyrimisht zbatohen ne zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabel.

Parimet e vijueshmerise, te drejtave te konstatura dhe qendrueshmerise jane pranuar gjithashtu si supozimet baze kontabel. Ne rast se nje ose te tre keto supozime (hipoteza) nuk qendrojne, atehere kjo duhet te paraqitet ne sqarimet e shpjegimet e pasqyrave financiare.

Politikat kontabel te zgjedhura dhe te aplikuara ne praktike duhet te paraqiten ne pasqyrat financiare nepermjet shenimeve dhe anekseve ne menyre te qarte. Shpjegimet e politikave kontabel jane pjese e pandare e pasqyrave financiare.

1. Parimi i vijueshmerise
2. Parimi i perputhjes dhe te drejtave te konstatuara
3. Parimi i qendrueshmerise
4. Parimi i njesise kontabile
5. Parimi i materialitetit
6. Parimi i moskompensimit
7. Parimi i neutralitetit dhe besueshmerise
8. Parimi i kujdesit

9. Parimi i permbajtjes mbi formen

1. Parimi i vijueshmerise

Sipas ketij parimi operacionet e Agjencise do te vazhdojne pa ndonje limit kohor (te pakten 12 muaj nga data e bilancit) dhe nuk ka ndonje qellim apo nevojë ne perfundimin e operacioneve apo kufizimin e shkalles se operacioneve ne te ardhmen. Nese operacionet e Agjencise do te pushojne se qeni te vazhdueshem, atehere kjo do te shpjegohet ne shenimet e pasqyrave financiare.

2. Parimi i perputhjes dhe te drejtat e konstatuara

Sipas parimit te perputhjes kuptohet ndarja e aktivitetit, i cili eshte i pakufizuar sipas parimit te vijueshmerise, ne periudha te caktuara dhe percaktimin e rezultateve te cdo periudhe i ndare ky nga periudhat e tjera.

Pasqyrat financiare te Agjencise, pervec pasqyres se Fluksit te Parave, pergatiten sipas parimit te drejtave te konstatuara. Sipas ketij parimi efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve te tjera njihen kur ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare dhe apo ekuivalentet e tyre arketohen apo paguhen) dhe regjistrohen ne kontabilitet dhe raportohen ne pasqyrat financiare te periudhave te cilave ato u perkasin.

Sipas parimit te perputhjes shpenzimet njihen (raportohen) ne pasqyren e te ardhurave-shpenzimeve ne baze te nje lidhje direkte midis kostove te ndodhura dhe perfitimeve te elementeve perkates te te ardhurave qe krijohen. Megjithate aplikimi i parimit te perputhjes nuk lejon njohjen e elementeve ne bilanc te cilet nuk hyjne ne perkufizimin e elementeve pasurore apo te detyrimeve. Keshtu psh. kostot do te njihen si aktiv nqs ato permbushin kriterin e njohtjes se nje aktivi.

3. Parimi i qendrueshmerise

Me kete parim kuptohet pershtatja e politikave kontabel te zgjedhura ne praktikat kontabel, pa i ndryshuar ato nga periudha ne periudhe. Sipas ketij parimi sigurohet krahesueshmeria e gjendjeve financiare dhe rezultateve financiare te periudhave vijuese.

Politikat kontabel te zbatueshme mund te ndryshohen kur ka arsye bindese.

Arsyet jane bindese kur jane rezultat i :

- a) *ndryshim i dallueshem i operacioneve te Agjencise*
- b) *identifikimi i nje paraqitjeje shume me te pershtateshme se e mepareshmja*
- c) *kerkesave te standarteve apo ligjore*

Megjithate, ndryshimet dhe efektet e tyre monetare duhet te shpegohen ne shenimet e pasqyrave financiare.

Sistemi raportues duhet te jete i qendrueshem, i krahesueshem, i pershtatur me tiparet e Agjencise, te mbuloje nevojat e saj dhe nuk duhet te ndryshohet derisa te jete e nevojshme dhe e detyrueshme.

4. Parimi i njesise kontabile

Sipas ketij parimi Agjencia e Sigurimit te Depozitave eshte njesi e ndare nga drejtuesit e saj, personeli dhe te gjithe personat e tjere te lidhur me te, dhe se transaksionet kontabile duhet te kryhen ne emer te saj.

Gjithashu pasqyrat financiare te Agjencise nuk pasqyrojne aktivet, pasivet apo operacionet e bankave ndaj depozituesve te se cilave ajo kryen kompesimin e depozitave.

5. Parimi i materialitetit

Sipas ketij parimi informacioni kontabel eshte material nese lenia menjane apo shtremberimi i tij mund te influencoje ne vendimet e perdoruesve te ketij informacioni. Kur vleresohet nese nje elemet eshte material, cdo rast do te gjykohe nga masa dhe natyra e tij. Vleresimi duhet te behet ne kontekstin e teresise se pasqyrave financiare dhe lidhjen e komponenteve perkates te pasqyrave financiare.

6. Parimi i moskompensimit

Sipas ketij parimi, kompensimi i aktiveve me pasivet apo te ardhurave me shpenzimet eshte i ndaluar.

Kompensimi nuk perfshin zbritjen e shumave qe perfaqesojne uljen e vleres se nje aktivi. Po keshtu paraqitjen e vleres kontabile neto te aktivit pa zhvleresimin e akumuluar nuk eshte shembull kompensimi.

7. Parimi i neutralitetit dhe besueshmerise

Sipas ketij parimi rregjistrimet kontabile duhet te bazohen ne dokumenta te besueshem te pergatitura ne perputhje me procedurat qe reflektojne kushtet aktule ekonomike dhe tregon nevojten e nje trajtimi neutral dhe pa paragjykime ne percaktimin e metodave baze ne rregjistrimet kontabile.

8. Parimi i kujdesit

Kur behen vleresimet e nevojshme per pergatitjen e pasqyrave financiare, Agjencia duhet gjithmone te pranoje pozicionin konservator per te shmangur rezikun qe mjetet ose te ardhurat te vleresohen me teper dhe detyrimet dhe shpenzimet me pak. Kujdesi eshte perfshirja e nje shkalle kujdesi ne e gjykimin e vleresimeve ne kushtet e pasigurise, ne menyre te tille qe aktive dhe te ardhurat nuk jane te mbi vleresuara dhe detyrimet dhe shpenzimet nuk jane te nen vleresuara.

Sipas ketij parimi ndersa provigjonet e nevojshme krijohen per shpenzime, humbje apo debitore, asnje regjistrim kontabel nuk kerkohet per te ardhura apo fitime te mundeshme.

Ushtrimi i parimit te kujdesit nuk lejon psh: krijimin e rezervave te fshehta, provigjoneve te teperta, nenvleresim te ndergjegjshem te te ardhurave dhe aktiveve, apo mbivleresim te ndergjegjshem te shpenzimeve dhe detyrimeve, sepse pasqyrat financiare nuk do te ishin te paaneshme dhe nuk do te gezonin cilesine e besueshmerise.

9. Parimi i permbajtjes mbi formen

Sipas ketij parimi eshte e nevojshme qe transaksionet dhe ngjarjet e tjera te paraqiten duke mbajtur parasysh thelbin e tyre dhe realitetin ekonomik me shume se sa formen juridike.

3. PARIMET E PERGJITHESHME TE MBAJTJES SE LLOGARIVE

Parimi i dokumentimit.

Rregjistrimet ne llogari bazohen ne parimin e egzistences se dokumentit (justifikimi), dmth ne dokumentet qe tregojne realizimin e shpenzimeve te ardhurave, te arketimeve ose te pagesave si per shembull, faturat e ndryshme leshohen sipas ligjit per kontabilitetin ose cdo dokument tjeter qe ka te njejten vlere.

Shmangiet nga ky parim lejohen vetem ne rastet e meposhteme:

- Kur dokumenti prodhohet me vonese ne kohe psh faturat e KESH-it, Telekomit ose ne rastin e llogaritjes si interesave te cilat llogariten ne afate kohore te percaktuara.
- Kur dokumenti eshte prodhuar dhe eshte nisur por nuk ka mbritur ne kohe psh kur ngaterohet adresa e marresit, ose ka humbur gjate dergimit.
- Kur vonohet prodhimi i dokumentit per shkak se vlera e tij nuk eshte percaktuar saktesisht psh. kur palet nuk bien dakort perfundimisht per madhesine e vleres qe do te dokumentohet dhe per kete arsye vonon prodhimi dhe mbritja (njekohesisht) e dokumentit.
- Kur madhesia e shpenzimit nuk eshte e njohur, por thjesht gjykohet nje madhesi e tij psh. ne rast kur parashikohen shpenzime te cilat mund te ndodhin ne te ardhmen. Qellimi i evidentimit kontabel te elementeve te koshtos, per te cilat nuk disponohet dokumenti, eshte percaktimi i koshtos ne periudha te shkurtera (me pak se nje vit).

Cilat elemente rregjistrohen ne llogari:

Ne llogari pervecse shumave ne debi dhe kredi rregjistrohen te pakten edhe elementet e meposhtem

- Numri rrites i dokumentit me te cilin behet kontabilizimi i shumes perkatese.
- Nje pershkrim i shkurter justifikues per cdo rregjistrim, dmth per cdo shume qe rregjistrohet ne debi ose ne kredi te llogarise.
- Mbajtja e detyrueshme e llogarive analitike. Per llogarite analitike te grades se fundit te kontabilitetit financiar dhe te llogarive te pozicionit financiar eshte e detyrueshme mbajtja analitike ne kartela ose ne cdo menyre tjeter.

Rregjistrimi i ketyre elemeteve krijon:

- Mundesi ne azhornimin e llogarive.
- Mundesi te azhornohen llogarite qofte edhe levizjet totale si te debitimeve ashtu edhe te kreditimeve, me kusht qe ky azhornim te behet sipas cdo menyre ne fund te cdo muaji.

4. PLANI I LLOGARIVE

Percaktimi i planit te llogarive.

Plani i llogarive eshte nje pasqyre (liste) ne te cilen paraqiten llogarite qe mban kontabiliteti te grupuara dhe te klasifikuara.

Ne praktike shpesh here barazohet plani i llogarive me planin kontabel, gje e cila eshte e gabuar pasi plani kontabel eshte nje term shume me i gjere.

Grupimi i llogarive.

Llogarite ne cdo plan llogarish grupohen me klasa ne baze te nje karakteristike te vecante.

Grupimi i llogarive behet:

- per te marre informacion te vlefshem ne shumet totale te cdo grupi (klase) dhe te krijojte lidhjet e nevojshme te te dhenave te klasave perkatese
- te lehtesoje kodifikimin e llogarise
- perfshirja e llogarive ne klasa varet nga kriteri qe do te perdorim i cili zgjidhet duke u mbështetur ne informacionet qe duam te rezultojne nga klasat e llogarive.
- Keshtu:
- Bazuar ne dallimin kontabel te llogarive krijohet nje klase e vecante per cdo kategori llogarish te aktivitetit te pasivitetit, te pozicionit te pastert, shpenzimeve, te ardhurave, dhe rezultateve.
- Ne baze te shpejtesise se qarkullimit te elementeve pasuror eshte e mundur qe ne grupe te perfshihen llogarite e aktiveve te qendrueshem, te kapitaleve te veta dhe detyrimeve afatgjata.
- Ne baze te mardhenieve ekonomike me te tretet eshte e mundur ne nje grup te perfshihen llogarite e detyrimeve dhe te drejtave afatgjata.

Simbolizimi i klasave dhe kodifikimi i llogarive.

Cdo klase te llogarive i vihet nje simbol i cili mund te jete germe kapitale, numer latin ose numer arab. Ne praktike ka mbizotruar simbolizimi i klasave me numra arab, kjo sepse lejon lidhjen e simbolit te klases me numrin e llogarive te klases, pra bashkohen numri i klases me ate te llogarise. Sistemet me te mira te kodifikimit te llogarive te cilat i kane rezistuar kohes dhe i sherbyen asaj me se miri jane sistemet dhjetor dhe qindesh fale transparences, thjeshtezimit dhe te memorizimit lehte.

Ne manual eshte zgjedhur sistemi kodifikimit te sistemit bankar i modifikuar per lehtesi perdorimi nga Agjencia.

Plan i Llogarive

Per grupimin e llogarive ne klasa u perdoren kriteret e trajtuar me siper.
Keshtu klasat e llogarive jane:

Klasa 1:	Veprime me mjetet likuide
Klasa 2:	Veprime me bankat e siguruara
Klasa 3:	Veprime me letrat me vlere (Bono Thesari)
Klasa 4:	Aktive te tjera dhe detyrimet e tjera
Klasa 5:	Aktivet e qendrueshme dhe burimet e perhereshme
Klasa 6:	Llogarite e shpenzimeve
Klasa 7:	Llogarite e te ardhurave
Klasa 9:	Llogarite jashte bilancit

5. LISTA E LLOGARIVE

Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 9
Veprime me mjetet likuide	Veprime me bankat e siguruara	Veprime me letrat me vlere (Bono Thesari)	Aktive te tjera dhe detyrimet e tjera	Aktivitet qendrueshme dhe burimet e perhereshme	Llogarite shpenzimeve	Llogarite ardhurave te	Llogarite bilancit jashte
10.10- Mjete monetare prane Bankes qendrore	20.10- Kontribute fillestare	30.10-Investime ne Bono Thesari te Qeverise Shqiptare me maturitet 1 vit	40.10- Debitore te Ndryshem	50.10- Aktive te Qendrueshme Patrupezuara	60.10 Shpenzime operative	70.10 Te ardhura nga veprimtaria e sigurimeve	90.10-Angazhime finacimi
10.20-Ekuivalente te mjeteve monetare	20.20- Prime te arketueshme.	30.20 Investime ne Bono Thesari te Qeverive te huaja me maturitet 1 vit	40.20- Materiale dhe te ngjashme	50.20- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	60.20 Shpenzime personeli	70.20 Te ardhura nga veprimtaria operative	90.20- Garanci
10.30- Llogari administrative prane bankave	20.30- Te tjera kerkesa	30.30 Investime ne Bono Thesari te institucioneve financiare me maturitet 1 vit	40.30- Provigjone	50.30-Kredi dhe financime	60.30 Tatime, taksa e te ngjashme		90.30-Angazhime tjera
10.40-Arka	20.40- Kerkesa per Arketim ndaj Bankave ne falimentim		40.40- Shpenzime te llogaritura dhe te ardhura te shytyra	50.40-Rezervat	60.40 Te tjera shpenzime	70.40 Te ardhura te tjera	
10.50- Mjete monetare prane bankave te tjera.	20.50- Interesa te Arketueshem nga Depozitat	30.50 Investime ne Bono Thesari me Qellime Tregetime	40.50- Kreditore te Tjere	50.50- Fondi akumuluar	60.50 Provigjone	70.50 Rimarje provigjonesh	
			40.60- Kompensimi i depozitave te siguruara	50.60- Fitim Humbje e vitit ushtrimor	60.60 Shpenzime falimentimi	70.60 Te ardhura nga falimentimi	
				50.70- Kapitali themetar.	60.70 Shpenzime te periudhave te kaluara dhe te ngjashme	70.70 Te ardhura te periudhave te kaluara dhe te ngjashme	
	20.80- Zhvleresim i kerkeseve per Arketim				60.80 Shpenzime te jashtzakoneshme	70.80 Te ardhura te jashtzakoneshme	
					60.90 Fitimi i vitit ushtrimor	70.90 Humbje ushtrimore	

10.00 MJETE MONETARE

10.10 Llogari prane Bankes Qendrore.

10.11 Depozite prane Bankes Qendore

.....

10.19-----

10.20. Ekuivalente te mjeteve monetare

10.21 Investime ne Bono Thesari te Qeverise Shqiptare me maturitet
deri ne 3 muaj

10.22 Investime ne Bono Thesari te Qeverive te Huaja me maturitet
deri ne 3 muaj

10.23 Investime ne Bono Thesari te Institucioneve Nderkombetare
Financiare me maturitet deri ne 3 muaj

10.24

.....

10.29-----

10.30 Llogari administrative prane bankave

10.31 Ne leke

10.32 Ne Valute

.....

10.39-----

10.40 Arka

10.41 Ne leke

10.42 Ne Valute

.....

10.49-----

10.50 Mjete monetare prane bankave te tjera

10.51 Ne leke

10.52 Ne Valute

.....

10.58

10.59-----

10.60

10.61

10.69-----

10.70

10.71

10.79-----

10.80

10.81

10.89-----

10.90

10.91

10.99-----

20.00 TE ARKETUESHME

20.10 Kontribute fillestare

20.11

20.19-----

20.20 Prime te arketueshme

20.21

20.29-----

20.30 Te tjera kerkesa

20.31

20.39-----

20.40 Kerkesa Per Arketim Ndaj bankave ne falimentim

20.41

20.49-----

20.50 Kerkesa per Arketim per Depozitat.

20.51

20.59-----

20.60

20.61

20.69-----

20.7020.71

20.79-----

20.80 (-) Zhvleresim i kerkesave per arketim

20.81

20.89

20.90
20.91

20.99-----

30.00 Investime Ne Letra Me Vlere (Bono Thesari)

30.10 Investime ne Bono Thesari te Qeverise Shqiptare me maturitet
deri ne 1 vit

30.11 Skonto (zbritje)/Prim

30.12 Interes i arketueshem

30.13

30.19-----

30.20 Investime ne Bono Thesari te Qeverise Huaja me maturitet deri ne 1 vit.

30.21 Skonto (zbritje)/Prim

30.22 Interes i arketueshem

30.23

30.29-----

30.30 Investime ne Bono Thesari te Institucioneve Nderkombetare

Financiare me maturitet deri ne 1 vit

30.31 Skonto (zbritje)/Prim

30.32 Interes i arketueshem

30.33

30.39-----

30.40

30.41

30.49-----

30.50 Investime ne Bono Thesari me qellime tregetimi

30.51

30.59-----

30.60

30.61

30.69-----

30.70

30.71

30.79-----

30.80

30.81

30.89-----

30.90

30.91

30.99-----

40.00 AKTIVE DHE DETYRIME TE TJERA

40.10 Debitore te ndryshem

40.11.Karte krediti (Paradhenie)

40.12

...

40.19-----

40.20 Materiale dhe te ngjashme

40.30 Provigjone

40.31 Provigjone te pergjitheshme

40.32 Provigjone per humbje nga falimentimi

40.33 Provigjone te tjera

...

40.39-----

40.40 Shpenzime te llogaritura dhe te ardhura te shtyra

40.41

...

40.45 Te ardhura te mara ne avance

40.46

...

40.49-----

40.50 Kreditore te tjera

40.51

...

40.59-----

40.60 Kompensim i depozitave te siguruara

40.61

...

40.69-----

40.70

40.71

...

40.79-----

40.80

40.81

...

40.89-----

40.90

40.91

...

40.99-----

**50.00 Aktive te Qendrueshme dhe Burime te Perhereshme te
Financimit.**

50.10 Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara

50.11

...

50.18 Zhvleresimi i AQPT

50.19-----

50.20 Aktive te Qendrueshme te Trupezuara

50.21

...

50.28 Zhvleresimi i AQT

50.29 Fond reserve per zhvleresim

50.30 Kredi dhe financime

50.31 Hua afatgjata

50.32 Hua afatshkurtera

50.31 Te tjera hua

...

50.35 Subvencione

50.36 Donacione

..

50.39-----

50.40 Rezervat per kapitalin Themeltar

50.41

...

50.49-----

50.50 Fondi i Akumuluar

50.51

...

50.59-----

50.60 Fitim Humbja e vitit ushtrimor

50.61

...

50.69-----

50.70 Kapitali Themeltar

50.71

...

50.79-----

50.80

50.81

...

50.89-----

50.90

50.91

...

50.99-----

60.00 Shpenzimet

60.10 Shpenzime operative

60.11 Shpenzimet materiale kancelari e te ngjashme

60.12 Shpenzime financiare

60.12.10 Interesa te llogaritura per kredi/hua afatgjata

60.12.11 Interesa te llogaritura per kredi/hua afatshkurtera

60.12.12 Interesa te llogaritura te tjera

60.12.13 Komisione bankare

60.12.14 Mirembajtje te tjera

60.12.....

60.13 Kuota e shpenzimeve per tu shperndare

60.14 Kuota e shpenzimeve te llogaritura

...

60.18 Amortizim i Aktiveve te Qendrueshme

60.18.10 Amortizimi i Aktiveve te Qendrueshme te Patrupezuara

60.18.11 Amortizimi i Aktiveve te Qendrueshem te Trupezuara

60.18.12 Shpenzime per fondin reserve per zhvleresim te AQT

60.19-----

60.20 Shpenzimet personeli

60.21 pagat

60.22 sigurimet

60.23 te tjera te ngjashme

...

60.29-----

60.30 Tatime, taksa dhe te ngjashme

60.31 Taksa vendore dhe te ngjashme

60.32 t.v.sh

60.33 te tjera tatime

...

60.39-----

60.40 Te tjera shpenzime operative

60.41 diferenca konvertimi

60.42 humbje nga shitja e investimeve ne letra me vlere

60.43 pagesa e keshillit mbikqyres

60.44 konsulenca e te ngjashme

60.45 Te tjera

60.49-----

60.50 Provigjone

60.51 provogjone te pergjitheshme

60.52 provigjone per humbje

60.53 te tjera provigjone

...

60.59-----

60.60 Shpenzime falimentimi

60.61 Humbje nga mosarketimi i kerkesave per arketim

...

60.69. -----

60.70 Shpenzime te periudhave te kaluara dhe te ngjashme

...

60.79. -----

60.80 Shpenzime te jashtzakoneshme

60.81

...

60.89. -----

60.90 Fitim i vitit ushtrimor

70.00 Te ardhura

70.10 Te ardhura nga veprimtaria e sigurimve

70.11 Te ardhura nga kontributi fillestar

70.12 Te ardhura nga primet

70.13 Te ardhura te tjera qe lidhen me to

70.14 Te ardhura nga gjobat

70.15 Te ardhura nga kamatvonesat

...

70.19. -----

70.20 Te ardhura nga veprimtaria operative

70.21 Te ardhura nga interesi i depozitave

70.22 *Te ardhura nga interesi i letrave me vlere*

70.22.10 Te ardhura nga interesi i letrave me vlere qeverise shqiptare

70.22.11 Te ardhura nga interesi i letrave me vlere qeverive te huaja

70.22.13 Te ardhura nga interesi i letrave me vlere institucioneve
financiare nderkombetare

70.23 Te ardhura te tjera qe lidhen me to

...

70.29. -----

70.30

70.31

...

70.39. -----

70.40 Te ardhura te tjera

70.41 Diferenca konvertimi

70.42 Te ardhura nga shitja e investimeve ne letra me vlere

70.43 Te tjera

...

70.49. -----

70.50 Rimarje Provigjonesh

70.51 Rimarje provigjonesh te pergjitheshme

70.52 Rimarje provigjonesh per humbje

70.53 Rimarje provigjonesh te tjera

...

70.59. -----

70.60 Te ardhura nga falimentimi

70.61 Te ardhura nga rikuperimi i kerkesave per arketim

...

70.69. -----

70.70 Te ardhura te periudhave te kaluara dhe te ngjashme

70.71

...

70.79. -----

70.80 Te ardhura te jashtzakoneshme

70.81

...

70.89-----

70.90 Humbje e vitit ushtrimor

PJESA II

1. PERMBAJTJA DHE FUNKSIONI I LLOGARIVE

Ne pershkrimin e permbytjeve dhe funksionimin e llogarive ndarja ne seksione eshte bere sipas klasifikimit ne bilanc.

Seksioni 1

10.00 MJETE MONETARE DHE EKUVALENTET

PERKUFIZIME DHE PARIME KONTABEL

Mjetet monetare perfshijne parate qe Agjencia mban prane saj dhe parate e depozituara prane Autoritetit Mbikqyres apo nje institucioni financiar dhe qe mund ti terheqe pa njoftim. Ekuivalentet e mjeteve monetare jane perkufizuar si investime afatshkurtera shume likuide (afati i maturimit te tyre eshte tre muaj ose me pak) dhe qe eshte e mundeshme te konvertohen ne shuma te njohura parash dhe qe mbartin nje risk te vogel persa i perket ndryshimit te vleres.

Njohja ne kontabilitet i mjeteve monetare.

Mjetet monetare njihen dhe rregjistrohen kur arketohen dhe ekuivalentet e tyre njihen kur investimi/depozita eshte bere.

10.40 Arka

Perfshin parate qe Agjenca mban prane saj me qellim plotesimin e nevojave te saj.

10.10 Banka prane Bankes Qendrore.

Kjo llogari i sherben agjencise per arketimin e primeve nga bankat e siguruara. Debitimi i kesaj llogarie behet ne kredit te nje llogarie te te ardhurave.

10.30 Llogari administrative prane bankave.

Llogaria e mesiperme sherben per mbulimin e shpenzimeve operative te Agjencise dhe furnizohet nga llogaria e Bankes Qendrore.

10.20 Bono thesari te qeverise Shqiptare me afat maturimi deri ne 3 muaj.

Pasqyron investimin e mjeteve te Agjencise ne letra me vlere te borxhit qeveritar por qe per shkak afatit te maturimit te tyre (jo me shume se tre muaj) do te pasqyrohen si mjete likujide. Pavarsisht ketij klasifikimi, Agjencia mund ti paraqese ato edhe ne seksionin e Investimeve te letrave me vlere Trajtimi kontabel i tyre, ne te dy rastet do te jete i njejte.(Shih Investime ne letra me vlere, bono thesari dhe obligacione deri ne 1 vit).

10.50 Te tjera llogari prane Bankave.

Pergjithesisht do te funksionojne si llogari te perkoheshme, pasi Agjencia do te perdore ato ne rastet e kompensimit te depozituesve.(shih kompensimin e depozitave te siguruara)

Ne lidhje me mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre Agjencia do te paraqese ne shenimet e pasqyrave financiare informacionin e meposhtem qe ka te beje:

- a) *Pershkrimin e tepericave te perfshira ne mjete monetare dhe ekivalente.*
- b) *Sqarime si investimet afatshkurtera jane klasifikuar ndermjet ekuivalenteve te mjeteve monetare dhe investimeve ne letra me vlere.*
- c) *Rakordimin e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre te perfshire ne pasqyren e fluksit te parase dhe*
- d) *Termat qe kane te bejne me mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre p.sh normen e interesit dhe afatin mesatar te maturimit.*

Seksioni 2

INVESTIME NE LETRA ME VLERE (BONO THESARI DHE OBLIGACIONE DERI NE 1 VIT)

Kuptohen ato letra me vlere qe percaktohen qarte ne ligjin Nr. 8873, date 29/3/2002, Neni 21 “Perdorimi i mjeteve financiare”, Pika 1, germa a,b,c,ç. Koha e investimit te letrave me vlere sipas Nenit 21, Pika 2 “Letrat me vlere te blera nga Agjensia nuk duhet te jene me maturitet me shume se nje vit qe nga momenti i fitimit te pronesise nga Agjensia.”

Ekzistenca e nje tregu likuid te letrave me vlere te borxhit Qeveritar e lejon Agjensine qe te bleje letra me vlere – sipas Nenit 21 – edhe per qellime tregetimi.

Llojet e tjera te letrave me vlere nuk jane objekt investimi i Agjensise.

PERKUFIZIME DHE PARIME KONTABEL

Rregjistrimi i investimeve ne letra me vlere ne kontabilitet behet me koston e blerjes, e cila eshte vlere e tregut shtuar me koston e transaksionit. Koston e transaksionit perfshijne tarifat dhe komisionet e paguara agjenteve, keshilltareve, apo ndermjetesve; taksat e agjencie rregullatore; dhe taksat e transferimit.

Sipas praktikave nderkombetare trajtimi kontabel i investimit ne letra me vlere pas njojtjes fillestare (me koston e blerjes), varet nga klasifikimi i tyre.

Klasifikimi

Agjencia mund te investoje ne letra me vlere (bono thesari dhe obligacione deri ne 1 vit) *me qellim per ti mbajtur deri ne maturim dhe me qellim tregetimi*.

Agjencia investon ne letra me vlere *te mbajtura deri ne maturim* (bono thesari dhe obligacione deri ne 1 vit) atehere kur ne daten e blerjes ka si qellim pozitiv mbajtjen deri ne maturim te tyre.

Agjencia investon ne letra me vlere *me qellim tregetimi* kur ajo i blen bonot e thesarit dhe obligacionet deri ne nje vit me qellimin per te patur fitime afatshkurtera nga tregetimi i tyre.

Vleresimi i letrave me vlere te mbajtura ne maturim

Vleresimi i bonove kur blerja e tyre eshte bere me qellim per tu mbajtur deri ne maturim behet me vleren kontabel neto. Vlera kontabel neto eshte

vlere nominale e letres me vlere duke i shtuar primin e pamortizuar apo pakesuar me skonton e paamortizuar.

Njohja e amortizimit te skontos apo primeve te investimve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim.

Investimi ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim (deri ne 1 vit) te blera me skonto apo prim rezulton kur interesi efektiv eshte i ndryshem nga interesi i vendosur ne to.

Udhëzuesit e zbatimit te standarteve nderkombetare kontabel (ICG) konfirmojne se :

Metoda e interesit efektiv eshte procedura qe duhet te perdoret per llogaritjen dhe regjistrimin e te ardhurave nga interesi dhe te primeve dhe skontove.

Per rrjedhoje Te ardhurat nga interesi nga investimet ne letrat me vlere te mbajtura deri ne maturim, per cdo periudhe kontabel perllogariten, nga ana e Agjencise, me normen efektive te interesit ne daten e blerjes. Keshtu qe cdo skonto apo prim amortizohet mbi jeten e mbetur te bonove pasi ne kete menyre vendoset shuma e duhur e te ardhurave nga interesi ne cdo periudhe kontabel.

Shitja e Investime ne letra me vlere para maturimit.

Agjencia mund te jete subjekt i kufizimeve ligjore apo kufizimeve te tjera, cka mund te shkatërojë qëllimin pozitiv të saj për të mbajtur investimet në letra me vlerë deri në maturim, atëherë kjo mund të çojë në shitje të tyre. Keshtu falimentimi i një banke mund ta çojë Agjencinë përballë nevojave urgjente për likuiditete të cilat nuk mund të mbulojë me mjete monetare, dhe kjo bën të domosdoshme shitjen e një pjese apo të tërën të portofolit të investimeve. Nëse një veprim i tillë ndodh atëherë për të duhet të rregjistrohet cdo humbje apo fitim nga transaksioni. Gjithashtu llogaria Investime në Letra me Vlerë të Mbajtura deri në Maturim zerohet (behët zero) dhe cdo interes i përfituar pas datës së fundit të interesit arketohet (mbledhet) nga blerësi i obligacioneve.

Para llogaritjes së fitimeve apo humbjeve nga shitja e investimeve, cdo skonto apo prim i obligacioneve amortizohet nga data e interesit të fundit deri në datën e shitjes. Kjo procedure është e nevojshme që të sigurojë që:

(1) është rregjistruar vlera e duhur e te ardhurave nga interesi i Letrave me Vlere; (2) është percaktuar drejt vlera e mbetur (carrying value) e investimit ne daten e shitjes.

Vlera e mbetur e investimit ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim krahesohet me cmimin e shitjes per te percaktuar fitimin apo humbjen. Fitimi apo humbja raportohet si shpenzim/e ardhur e zakoneshme, pervecse kur Agjencia i konsideron shpenzimet/te ardhurat si jo te zakoneshme dhe jo te shpeshta (unusual and infrequent), rast ne te cilin te ardh/shpenzimet raportohen si elemente te jashtezakonshem ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Vleresimi i letrave me vlere me qellim tregetimi¹.

Vleresimi i letrave me vlere te blera per kete qellim behet me vleren e tregut. Te gjitha rregullimet ndaj vleres se tregut per kete lloj investimi rregjistrohen si:

- rregullim direkt qe i behen llogarise se letrave me vlere (30.50).
- fitim/humbje neto te mbajtura te parealizuara te cilat pasqyrohen ne pasqyren e te ardhurave shpenzimve.

30.22 Interesa per arketim te lidhura me investimet ne letra me vlere.

Ne keto llogari rregjistrohen shumat e interesave te maturuara nga investimet ne letra me vlere. Debiti i kesaj llogarie aktivi rregjistrohet ne kredit te nje llogarise Te ardhura nga interesi.

¹ Sipas standarteve nderkombetare kontabel (IAS 39) rregullimi behet per te gjithë portofolin e letrave me vlere qe mbahen per qellime tregetimi.

Shembull numerik per investimin ne letra me vlere (obligacione) te mbajtura deri ne maturim.

Supozojme se Agjencia blen obligacione per ti mbajtur deri ne maturim, me vlere nominale (principal) 100.000 leke, interest e vendosur (kupon) prej 9% me 1 Gusht 200x. Blerja e obligacioneve behet per 99.000 leke plus interesin e perlllogaritur. Interesi i obligacioneve paguhet cdo 6 mujor perkatesisht me 31 Maj dhe 30 Nentor. Rregjistrimi ne ditar i veprimit te kryer me 1 gusht 200x do te jete:

30.20 Investime ne letra me vlere	
te mbajtura ne maturim	99.000
70.22 Te ardhura nga interesi $(100.000 \cdot 0.09 \cdot 2/12)$	1.500
Banka	100.500

SQARIME: Llogaria e investimeve eshte debituar per 99.000 leke. Pra sic shihet skontoja prej 1.000 leke eshte perfshire direkt ne llogarine e investimeve dhe kjo skonto amortizohet si nje rregullim i te ardhurave nga interesi. (kete do te paraqesim ne vijim te shembullit).

Gjithshtu llogaria e te ardhurave nga interesi eshte debituar per interesin e llogaritur te dy muajve. Llogaria e te Ardhurave nga interesi do te kreditohet per 4.500 leke kur me 30 Nentor 200X interesi 6 mujor do te jete arketuar, duke rezultuar ne njohjen e 3.000 leke si interes i perfitur per periudhen 1 gusht deri me 30 nentor 200X

NJOHJA E AMORTIZIMIT TE PRIMEVE DHE SKONTOVE

Kontabilizimi i primeve : Supozojme se Agjensia investon ne obligacione qe do te mbahen deri ne maturim, me nje vlere minimale 100.000 leke , duke paguar 100,916 leke me 1 janar 200X. Norma e vendosur e interesit ne keto obligacione eshte 13% e pagueshme cdo 6 muaj perkatesisht me : 30 Qershor dhe 31 Dhjetor; maturimi i tyre behet me 31 Dhjetor 200X dhe ato tregtohen ne treg me nje norme interesi 12% (*norma e interesit efekti*) .

Regjistrimin ne regjistrat e Agjencise me 1 Janar 200X, per te pershkruar blerjen e obligacioneve do te jete:

30.20 Investime ne letra me vlere
te mbajtura ne maturim _____ 100.916
10.50 Banka _____ 100.916

Perdorimi i metodës se interesit efektiv.

Arketimi i interesit me 30 Qershor 200X duke perdorur metoden e interesit efektiv per obligacione te blera me prim regjistrohet si me poshte:

10.50 Banka _____ 6.500
30.20 Investime ne letra me vlere
te mbajtura ne maturim _____ 445
70.22. Te ardhura nga
interesi i letrave me vlere _____ 6.055

Paraqitjen e metodës se interesit efektiv dhe llogaritjet perkatese i kemi pasqyrar ne tabelen e meposhteme:

Tabela 2.1

Data	Arketimi interesit Debit ^a	Te ardhura ng interesi Kredit ^b	Investim ne l.v te mbajtura ne mat. Kredit ^c	Vlera e mbetur e investimit ne l.v te mbajtura deri mat. ^d
01.01.200X	-	-	-	100,917
30.06.200X	6,500	6,055	445	100,472
31.12.200X	6,500	6,028	472	100,000

a-100.000 (vlera nominale) * 13% (norma e vendosur) * 1/2 (viti)

b- Vlera e mbetur e meparshme e investimit ne l.v * 12% (norma efektive e interesit) * 1/2 (viti)

c- diferenca a-b

d- Vlera e mbetur e meparshme e investimit ne l.v minus vleren e nxjerre nga c.

① shifrat e mesiperme per thjeshtesi ne llogaritje jane te rrumbullakosura.

Kontablizimi i skontove;

Le te supozojme se Agjencia blen obligacione, te cilat do ti mbaje deri ne maturim, me skonto per 99.096 leke. Shitja e obligacioneve me skonto tregon se norma e vendosur ne kupon eshte me e vogel se norma efektive. Ne rastin ne fjale norma e vendosur (kuponi) eshte 13% ndersa norma efektive (yield) eshte 14%.

Arketimi i interesit me 30 Qershor 200X duke perdorur metoden e interesit efektiv per obligacione te blera me skonto regjistrohet si me poshte:

10.50 Banka _____ 6.500
 30.20 Investime ne letra me vlere
 te mbajtura ne maturim _____ 437
 70.22. Te ardhura nga
 interesi i letrave me vlere _____ 6.937

Paraqitjen e metodes se interesit efektiv dhe llogaritjet perkatese i kemi pasqyruar ne tabelen e meposhteme:

Tabela 2.2

Data	Arketimi i interesit Debit ^a	Te ardhura nga interesi Kredit ^b	Investim ne l.v te mbajtura ne mat. Debit ^c	Vlera e mbetur e investimit ne l.v te mbajtura deri mat. ^d
01.01.200X	-	-	-	99.096
30.06.200X	6.500	6.937	437	99.533
31.12.200X	6.500	6.967	467	100.000

a-100.000 (vlere nominale) * 13% (norma e vendosur) * 1/2 (viti)

b- Vlera e mbetur e meparshme e investimit ne l.v *12% (norma efektive e interesit) *1/2 (viti)

c- diferenca b-a

d- Vlera e mbetur e meparshme e investimit ne l.v plus vleren e nxjerre nga c.

① shifrat e mesiperme per thjeshtesi ne llogaritje jane te rrumbullakosura.

SHITJA E INVESTIMIT NE BONO THESARI APO OBLIGACIONE PARA MATURIMIT.

Sic e trajtuam edhe me siper, ndryshime te caktuara ne mjedisin ekonomik ne te cilin vepron Agjencia mund te cojne ne shitjen e letrave me vlere te mbajtura deri ne maturim.

Supozojme se obligacionet, 100.000 leke vlere nominale, 13% interes i vendosur (kupon), te blera nga Agjencia per 99.096 leke (te cilat i kemi

diskutuar edhe me siper) u shiten me 31 Gusht 200X per 99.890 leke plus interesin rrjedhes.

Rregjistrimet ne ditarin kontabel te Agjencise me 31 Gusht 200X (duke supozuar se skontoja e obligacioneve amortizohet sipas metodes se interesit efektiv sic ilustruhet ne tabelen 2.2) jane:

30.20 Investime ne letra me vlere	
te mbajtura ne maturim $(467:6 \times 2)^2$	157
70.22. Te ardhura nga	
interesi i letrave me vlere	157
10.50 Banka $(99.890 + 2167)$	102.057
30.20 Investime ne letra me vlere	
te mbajtura ne maturim $(99.533 \text{ vlera}$	
e nxjerre nga tabela 2.2 plus 157)	99.690
70.22. Te ardhura nga	
interesi i letrave me vlere	2.167
70.40 Te ardhura nga shitja	
e l.v te mbajtura ne maturim	200

SQARIME: Rregjistrimi i pare ne ditar e sjell vleren e mbetur te investimit ne daten e shitjes. Ne rregjistrimin e dyte debiti i Bankes rregjistrohet cmimin e shitjes plus interesin e perfutur ne dy muaj qysh nga pagesa e kuponit ne qershor 200X, kreditimi i llogarise se investimeve zeron vleren e mbetur te investimit ne daten e shitjes. Fitmi nga shitja llogaritet nga krahesimi i vleres se mbetur te investimit ne daten e mbylljes 99.690 leke me cmimin e shitjes 99.890 leke.

² Amortizimi i skontos, per lehtesi ne llogaritje, behet proporcionalisht me periudhen e mbajtjes se obligacioneve. Keshtu nga 30.06 deri me 31.08 jane 2 muaj, periudhe per te cilen do te llogaritet edhe amortizimi i skontos.

Seksioni 3

KERKESA PER ARKETIM (NDAJ BANKAVE TE FALIMENTUARA)

Keto kërkesa paraqesin te drejta ndaj bankave te falimentuara, te cilat rrjedhin nga cedimi i tagrave dhe te drejtave te depozituesve, per shumat e kompesuara. Pra kemi te bejme me nje te drejte te Agjencise se Sigurimit te Depozitave ndaj bankave te falimentuara me qellim qe Agjencia te rimarre pagesat e kompensimit te depozitave dhe kostot e tjera qe kane shoqeruar keto pagesa.

Trajtimi kontabel i kërkesave per arketim.

Kur Agjencise se Sigurimit te Depozitave i cedohen (i transferohen) tagrat dhe te drejtat e depozituesve, te bankes qe ka falimentuar, llogaria *Kërkesa per arketim* duhet te pasqyrohet si llogari aktive jashte bilancit. Ky veprim kontabel behet pasi kërkesat-dhe-rikuperimi i tyre jane funksione “jashte duarve” te Agjencise, ç`ka do thote se ne fazen fillestare ka pasiguri ne pasqyrimin si llogari bilanci. Debitimi i kesaj llogarie behet ne kredit te nje llogarie pasive jashte bilancit 90.10 *Te ardhura ne pritje per arketim*.

Kur drejtimi i Agjencise se Sigurimit te Depozitave, gjykon se ka *informacionin e mjaftueshem*³ se arketimi i shumave nga shitja e aktiveve te bankave te falimentuara eshte e mundeshme dhe per pasoje rimbursimi i shumave (plotesisht apo pjeserisht) qe Agjencia u ka paguar depozituesve eshte i mundshem ateherë llogaria 20.40 *Kërkesa per arketim* transferohet ne llogari aktive te bilancit ne kunderparti te nje llogarie te te ardhurave 70.61 *Te ardhura nga rikuperimi i kërkesave per arketim*. Eshte e rendesishme te theksohet se ne kërkesat per arketim ndaj bankave te falimentuara do te perfshihet cdo kosto financiare qe shoqeron si kompensimin ashtu edhe kerkimin-dhe-rikuperimin. Nga kjo pikpamje *vleresimi i kërkesave per arketim eshte procesi i korrektimit te tyre*.(shih zhvleresimin e kërkesave per arketim)

Konkluzion: Kërkesat per arketim ndaj bankave te falimentuara kalojne ne dy faza; si fillim kur mungon informacioni i mjaftueshem per mundesine e rimbursimit keto kërkesa pasqyrohen ne llogari aktive jashte bilancit dhe kur drejtimi i Agjencise ka informacionin e nevojshem per njohtjen e tyre behet pasqyrimi ne Kërkesa per arketim (mbi ose nen 1 vit)

³ Informacioni i mjaftueshem sigurohet nga likujdatorët e bankave te falimentuara, Autoriteti Mbikqyres, si dhe nga te gjitha palet e lidhura me Agjencine.

20.80 Zhvleresime te kerkesave per arketim

Shumat e zhvlersimeve per kerkesat per arketim pasqyrojne vleresimim me te mire persa i perket humbjeve nga keto kerkesa. Zhvleresimet njihen duke vleresuar rezultatet e pritshme te strategjise se shitjes se aktiveve, bazuar kjo ne informacionin te cilin Agjencia e merr nga likujdatorët e bankave te siguruara apo nga Autoriteti Mbikqyres.

Zhvleresimet e kerkesave per arketim zbriten nga kerkesat e arketueshme plotesisht apo pjeserisht kur nuk ka pritje te mundeshme te realizmit te tyre. Ne situata te caktuara, Agjencia mund te arketoje shuma nga kerkesa te arketueshme te cilat me perpara jane zhvleresuar. Ne situata te tilla cdo arketim fillimisht rrimeret ndaj zhvlersimeve dhe cdo arketim shtese njihet si e ardhur.

20.20 Prime te arketueshme

Pasqyron shumen e primeve te maturuar por per te cilat nuk eshte kryer kalimi ne llogari te Agjencise nga banka e siguruar.

Debiti i kesaj llogarie, kreditohet ne llogarine e te ardhurave *Te ardhura nga primet*. Llogaria Prime te arketueshme kreditohet ne debit te llogarise se Mjeteve monetare per shumen e arketimit ne favor te Agjencise.

20.50 Interers i Arketueshem nga Depozitat.

Kjo llogari pasqyron interesin e arketueshem qe perfitohet nga mjetet likuide te Agjencise. Debitimi i kesaj llogarie behet ne kredit te llogarise se te Ardhurave nga interesi.

Seksioni 4

AKTIVE TE TJERA

Aktivet e Qendrueshme

Perfshijne elemente te pasurise te Agjencise qe destinohen ti sherbejne veprimtarise se saj per nje kohe te gjate si rregull mbi nje vit. Sipas ligjit per kontabilitetin qe nje element te perfshihet si aktiv i qendrueshem duhet qe edhe kostoja e blerjes te jete me e madhe se 5000 leke.

Aktivet e Qendrueshme Te Trupezuara dhe Patrupezuara

Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara

Ne pjesen me te madhe ato perbehen nga elemente te tilla qe perfaqesojne fondet tregetare, e drejta e qerases, te drejtat e votes, licencat, patentat tregetare, teknikat, programet kompjuterike, te perftuara ose te projektuara per perdorim te brendshem.

Shpenzimet e nisjes dhe shpenzimet e paraveprimtarise, nese mendohet se jane te nevojeshme per nisjen e biznesit, mund te kapitalizohen dhe llogariten si "Aktive te paturupezuara". Ato amortizohen gjate nje periudhe 5 vjecare me keste te barabarte.

Aktive te Qendrueshme te Trupezuara.

AQT perbehen nga pronat, aparatet dhe pajisjet te cilat jane objekt i nje te drejte pronesie dhe poseidohen nga Agjencia per prodhimin e sherbimeve te saj.

40.40 Shpenzime te shtyra

Jane shuma te paguara nga Agjencia gjate vitit kontabel te cilat do te njihen si shpenzime ne periudhat e ardheshme.

PERKUFIZIMET DHE PARIMET KONTABEL E A.Q

VLERA KONTABEL

Aktivet e Qendrueshme kontabilizohen nga Agjencia me dorzimin e pajisjeve dhe mbahen ne libra me koston historike, kosto e perfitimit.

Kosto e perfitimit i korrespondon cmimit neto te blerjes plus shpenzimet e rastit qe jane perfaqesuese te vleres se tregut. Shpenzimet e rastit perbehen nga shpenzimet qe lidhen me perfitimin prej shpenzimeve te drejtperdrejta dhe te terthorta duke ditur qe keto lidhen me perfitimin.

Shpenzimet e rastit perfshijne:

Transportin

Detyrimet doganore

Shpenzimet paraprake (perfshi pagat e punes)

Shpenzime te prishjes se mjetit egzistues kur paraprijne menjehere krijimin e nje mjeti te ri

Tvsh dhe taksa te tjera te pazbriteshme

Por nuk perfshijne:

